



**RREGULLORE**  
**PËR PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE NË PUNË**  
**DHE**  
**PËR AMBIENT TË SIGURT**

Dhjetor 2018

Ne baze te dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë HANDIKOS, nxjerr këtë rregullore te emëruar: Rregullore për pajisjet personale mbrojtëse në punë dhe për ambient të sigurt

## Neni 1

A. Kjo Rregullore përmban parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe ambient te sigurt ne pune. Me këtë rregullore përcaktohen pajisjet personale mbrojtëse në punë, si dhe ambient i sigurt ne pune me qëllim të përmirësimit të shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve.

B. Me qëllim te implementimit te masave te sigurisë ne mënyrën te drejte personeli organizatës, Organizon dhe kontrollon vizitën e punëtove ne kontrollime sistematike mjekësore dhe i raporton mbi gjendjen shëndetësore te stafit drejtori te organizatës. Kontrolli mjekësor organizohet te paktën 1 here ne 3 vite për te punësuarit qe janë ne marrëdhënie te punës, ndërsa për rekrutet e ri te paktën 3 muaj pas themelimit te marrëdhënies te punës.

C. Zyrtari i Logjistikes, bene kontrollin e pajisjeve dhe evidenton mundësit eventuale te cilat mund te paraqesin rrezik ne pune ne vazhdimësi, te paktën njëherë ne vite dhe me shkrim i raporton drejtorit. Për kryerjen sa ma te sakte te kontrollit për evidentimin e shkaqeve qe mund te paraqesin rrezik zyrtari, mund te kërkon angazhimin e ekspertit kompetent për këtë lëmi

## Neni 2

1. Në kuadër të përgjegjësisive të tij, punëdhënësi për vendet e punës në pajtim me ligjin dhe këtë rregullore, detyrohet të caktoj pajisjet personale mbrojtëse (PPM) si masë për siguri dhe shëndet në punë, si dhe pajisjet për ambient te sigurt ne pune.

2. Lista e pajisjeve personale, mbrojtjes për vendet e caktuara të punës në janë si:

Nr.	Vendi i punës	Lloji i mjeteve të mbrojtjes personale	copë	Afati i vjetërsisë	Obliguar/ preferuara
1	VOZITËS/LOGJISTIKA	Rroba vere Rroba dimri Dorëza pune Sinjalizues Pajisje dimërore për veture	1	24 Muaj	Obliguar
2	PUNËTOR NË SIGURIM DHE ROJE NATE	Rroba pune vere Rroba pune dimri  Këmishë Bateri/ drite nate	1	24 Muaj	Obliguar
3	FIZIOTERAPEUTET/EDUK ATORET	Kontrolli shëndetësor çdo vitë Pastërtia ne dhomën e shërbimeve çdo fillim te javës pastërti te detajuum.	1 1	12 Muaj 7 dite	Obliguar



B. M

3. Lista e pajisjeve, mbrojtjes për siguri ne objektin e punës janë si ne vijim:

Nr.	Paisjet ne Objekt	Lloji	Cope	Afati	Obliguar
1	LOGJISTIKA	Aparate për mbrojtjen nga zjarri	Sipas m2 për çdo 100 m2 cope 2	12 muaj	Obliguar
2	LOGJISTIK	Pajisje për ndihmën e pare	Sipas m2 për çdo 100 m2 1 cope	48 muaj	Obliguar
3	LOGJISTIKA	Shenja për ndalimin e pirjes se duhanit	Cdo 100 m2	24 muaj	Obliguar
4	LOGJISTIKA	Hidrantet për mbrojtjen kundër zjarrit	Cdo 500 m2	50 mauj	Obliguar
5	LOGJISTIKA	Dalja emergjente/shënimi i daljeve emergjente	Te paktën 1		Obliguar
6	LOGJISTIKA	Hapësirë për dhënie e ndihmës se pare	Te paktën 1		Preferuar
7	LOGJISTIKA	Hapësirë e nevojshme për pushim	Te paktën 1		Preferuar

Neni 3

1. Mjetet për pajisje personale mbrojtëse (PPM) në pajtim me ligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë e të përshkruara në nenin 2 paragrafi 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje do të sigurohen nga punëdhënësi.

2. Punëdhënësi për punëmarrësit të cilët punojnë në nxemje të cilët i ekspozohen gazrave, erërave të ndryshme, pluhurit, kushteve të përgjithshme higjienike dhe në rastet tjera ku konstatohet se ka koncentrim të pluhurit dhe ajrit e që dëmtojnë shëndetin e punëmarrësve ka për obligim të sigurojë nga **një (1) litër qumësht** për çdo ditë pune për të punësuarin.

Neni 4

Ankesat dhe pakënaqësitë lidhur me ambientin e punës dhe PPM duhet t'i drejtohen menaxherit, zyrtarit te logjistikes apo zyrës se personelit.

Neni 5

1. Punëdhënësi obligohet që të sigurojë kushtet dhe masat e nevojshme të parapara me këtë rregullore.

2.Për të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë të përfshira me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës.



B.M.



*Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 dhe 3 të statutit të organizatës HANDIKOS,  
Kuvendi i Anëtareve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 17.07.2019  
Aprovon dokumentin e titulluar Rregullore për Pajisjet Personale Mbrojtëse në Punë dhe për Ambient të Sigurt,  
dokumenti përbehet në gjithsej 3 faqe me 5 nene*

Kryesues i Kuvendit të Anëtareve, Bujar Morina

---

